

AMBASADORI WOLLFARTH I PËRGJIGJET INTERESIMIT TË MEDIAS

3 prill 2012

Pyetje: Cili është mendimi juaj në lidhje me reformën zgjedhore, për atë çfarë partitë politike po bëjnë dhe për hapat që duhet të ndërmerren? Jeni i kënaqur me atë çfarë është bërë deri tani?

Ambasadori Wollfarth: Hapa të rëndësishëm janë marrë, por ka mbetur ende edhe shumë punë për të bërë. Koha deri në fund të muajit nuk është shumë e gjatë. Fundi i prillit është vetëm disa ditë larg. Është e rëndësishme të përdoret sa më mirë kjo kohë për të arritur rezultate bazuar mbi këtë klimë konstruktive, për ta ruajtur këtë klimë e për ta përdorur atë sa më mirë për të hartuar një projekt-propozim të mirë për Kodin e ri Zgjedhor.

Pyetje: Cili është mendimi juaj në lidhje me gjykatën administrative, për faktin që nuk është arritur ende konsensus? Është menduar të krijohet një koleg civil nga gjykata e larta, por ende nuk është arritur një marrëveshje. Çfarë mendoni se i pengon partitë politike të arrijnë një konsensus në lidhje me këtë çështje kaq të rëndësishme?

Ambasadori Wollfarth: Përpara se të miratohet një ligj kaq i rëndësishëm, padyshim, duhen zhvilluar diskutimet e duhura. Do të dëshiroja shumë që konsensusi të arrihej në të ardhmen e afërt, sepse kjo është shumë e rëndësishme për investimet në Shqipëri dhe për zhvillimin ekonomik të saj. Vendet e punës janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë.

Pyetje: Gjithmonë përpara zgjedhjeve, forcat politike bëjnë ndërhyrjen në legjislacionin zgjedhor. A është kjo një gjë serioze dhe si mund të zgjidhet?

Ambasadori Wollfarth: Diskutimi për Kodin Zgjedhor zhvillohet në komisionin e posaçëm parlamentar, ku palët e përfaqësuara në parlament janë të pranishme. Nuk kam gjë të tjetër për të shtuar, ai është vendi i duhur për të diskutuar. Gjithashtu, ka qenë edhe nevoja për komunikim me shoqërinë civile [si, për shembull, në grupin e punës së javës së kaluar], një vendim shumë i rëndësishëm, por elementi më i rëndësishëm është diskutimi dhe përgatitja brenda komisionit parlamentar.

Pyetje: Sa efikas është numërimi elektronik?

Ambasadori Wollfarth: Mund të jetë efikas, por kjo varet nga sistemi i përzgjedhur. Çështja më e rëndësishme është të ketë besim midis njerëzve, midis operatorëve dhe kjo është diçka që nuk mund të zëvendësohet. Besimi mes njerëzve është element thelbësor në ndërtimin e demokracisë dhe zhvillimin e zgjedhjeve.

Pyetje: Mendoni se do ketë konsensus në lidhje me zgjedhjen e Presidentit apo mendoni se nuk ka problem nëse është maxhoranca që vendos, siç e lejon edhe legjislacioni aktual?

Ambasadori Wollfarth: Kushtetuta aktuale vërtet e lejon këtë, por është shumë e rëndësishme që të përdoret sa më mirë koha e mbetur për të gjetur një kandidat apo disa kandidatë të përshtatshëm.